



ANKETA E OFERTËS SË TURIZMIT NË KOSOVË 2023

Përgatitur nga:

Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE)

Projekti PPSE zbatohet nga Swisscontact-i si zbatues kryesor, në konsorcium me Institutin Riinvest.
Financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Kosovë (SDC).

Përmbajtja

1. Hyrje	2
2. Metodologjia	3
2.1. Hartimi i pyetësorit	3
2.2. Anketuesit	3
2.3. Dizajni i mostrës.....	3
2.4. Puna në terren	4
2.5. Përpunimi dhe analiza e të dhënave.....	4
3. Të gjeturat e anketës	5
3.1. Akomodimet me restorante	5
3.2. Akomodimet (pa restorante).....	18
3.3. Restorantet	32
3.4. Atraksionet.....	44
3.5. Operatorët turistikë.....	49
3.6. Ngjarjet kombëtare/Festivalet	52
4. Ndikimi ekonomik	56
4.1. Akomodimet	56
4.2. Restorantet	58
4.3. Të hyrat e përgjithshme të vlerësuara dhe punësimi	59

1. Hyrje

Ky raport paraqet të gjeturat e anketës vjetore të projektit Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (ang. Promoting Private Sector Employment, së këndejmi PPSE) me akterët kryesorë të sektorit të turizmit në Kosovë, duke përfshirë: sektorin e akomodimit, restorantet, operatorët e atraksioneve, operatorët turistikë dhe jo vetëm. Anketa e PPSE-së për ofertën e turizmit në Kosovë është hartuar për herë të parë në vitin 2018, duke mbuluar vitin 2017, dhe ky është studimi i shtatë radhazi që nga ajo kohë. Ky raport kryesisht interpreton gjetjet e vitit 2023 dhe përshkruan ndryshimet që kanë ndodhur krahasuar me periudhat e mëparshme.

Një nga sektorët me prioritet të projektit të PPSE-së është turizmi. Në kuadër të këtij sektori, projekti është kryesisht i përqendruar në lehtësimin e zhvillimit të produkteve të reja turistike, ri-shfrytëzimin e atraksioneve, aktivitete promovuese në arenën ndërkombëtare dhe riorganizimin e tërë sektorit - e gjitha kjo në funksion të gjenerimit të vendeve të reja të punës në Kosovë.

Disponueshmëria e të dhënave të sakta dhe të azhurnuara të turizmit si dhe informacionet e përgjithshme të tregut, janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të projektit. Anketa vjetore e PPSE-së për ofertën e turizmit në Kosovë është me rëndësi të madhe për PPSE-në, sepse i mundëson ekipit të monitorojë trendet e rritjes së sektorit të turizmit dhe të zhvillojë intervenimet sipas nevojës. Poashtu, është shumë e vlefshme për politikëbërësit, ofruesit e shërbimeve të turizmit dhe palët e tjera të interesit kur bëhet fjalë për proceset e planifikimit strategjik dhe vendimmarrjen në përgjithësi.

Pjesa tjetër e këtij raporti të anketës është e organizuar si në vijim. Pjesa 2, ofron një pasqyrë të përgjithshme të metodologjisë së përdorur për grumbullimin e të dhënave. Pjesa 3, paraqet të gjeturat kryesore të anketës dhe jep ilustrime që tregojnë ndryshimet në baza vjetore. Pjesa 4, analizon ndikimin ekonomik të turizmit, kryesisht duke u fokusuar në të ardhurat dhe punësimin e krijuar nga akterët kryesorë.

2. Metodologjia

Kjo pjesë paraqet qasjen metodologjike të përdorur për kryerjen e anketës. Kjo pjesë përshkruan dizajnin e pyetësit, përzgjedhjen dhe trajnimin e anketuesve, dizajnin e mostrës, procesin e mbledhjes së të dhënave si dhe përpunimin dhe analizimin e të dhënave.

2.1. Hartimi i pyetësit

Për qëllime krahasimi, anketa e përdorur këtë vit është pothuajse e njëjtë me anketën e parë. Pyetësi përmban kryesisht pyetje me zgjedhje të shumëfishta dhe disa pyetje të hapura - të dyja shumë të rëndësishme për të marrë informacionin e synuar.

2.2. Anketuesit

Rreth 30 anketues janë rekrutuar për të kryer intervistat me akterët e ofertës së turizmit. Me qëllim që anketuesit e rekrutuar të familjarizohen me qëllimin kryesor dhe nevojat specifike të anketës, është organizuar një trajnim një-ditor. Shpjegime të detajuara janë dhënë mbi variablat e përfshira krahas këshillave rreth procesit të intervistimit. Përveç kësaj, është organizuar një ushtrim praktik për të vlerësuar nëse anketuesit ishin në gjendje të ndiqnin udhëzimet e dhëna.

2.3. Dizajni i mostrës

Para së gjithash, vlen të përmendet se gjatë procesit të përzgjedhjes së mostrës, objektivi ishte identifikimi i subjekteve turistike të qasshme. Për të identifikuar listën e akterëve kryesorë të turizmit, janë përdorur platforma të ndryshme online. Prioritet ishte që të intervistoheshin të njëjtat subjekte sikurse në periudhat e mëparshme, në mënyrë që krahasimi nga viti në vit të jetë më kredibil dhe i besueshëm. Më poshtë është shpjegimi se si është identifikuar secili grup i popullacionit dhe madhësia e mostrës.

- Akomodimet turistike të qasshme (duke përfshirë akomodimet Airbnb) janë identifikuar në Booking.com, Trivago, AirBnB, dhe Facebook; 137 prej tyre janë intervistuar; 68 kanë ofruar vetëm akomodim, ndërsa 69 kanë ofruar akomodim me restorante.
- Restorantet janë gjetur në TripAdvisor dhe Gjirafa; 233 prej tyre janë intervistuar.
- Janë intervistuar 19 atraksione, 17 operatorë turistikë, dhe 15 festivale/ngjarje kombëtare të nxjerra nga një listë e ofruar nga PPSE.
- Gjithsej, janë zhvilluar 421 intervista sy më sy.

Tabela 1 ofron një krahasim me vitet e mëparshme. Duhet të theksohet se disa ofrues të shërbimeve të intervistuar në vitet e mëparshme nuk kanë mundur të intervistohen në vitin 2023, qoftë për shkak të mbylljes së biznesit ose nuk kanë pranuar të marrin pjesë në anketë. Disa të tjerë, të cilat tani janë të listuar në njërin prej platformave turistike të qasshme, janë shtuar në mostër.

Tabela 1: Shpërndarja e intervistave						
Lloji i ofruesit të shërbimeve	Numri i intervistave (2018)	Numri i intervistave (2019)	Numri i intervistave (2020)	Numri i intervistave (2021)	Numri i intervistave (2022)	Numri i intervistave (2023)
Akomodime me restorante	88	89	79	72	65	69
Akomodime	89	99	95	87	77	68
Restorante	205	229	247	263	211	233
Atraksione	32	17	30	26	22	19
Operatorë turistikë	18	29	17	17	23	17
Festivale/ngjarje kombëtare	36	32	31	-	24	15

2.4. Puna në terren

Anketuesit e rekrutuar kanë zhvilluar intervista sy më sy me pronarët ose menaxherët e subjekteve të identifikuar. Procesi i mbledhjes së të dhënave për vitin 2023 është zhvilluar përgjatë muajve gusht dhe shtator 2023. Secila intervistë ka zgjatur rreth 30-40 minuta.

2.5. Përpunimi dhe analiza e të dhënave


Të dhënat e mbledhura janë futur në fletët e të dhënave në Excel, të përgatitura posaçërisht për këtë anketë. Pastaj, të dhënat janë transferuar në SPSS (pako softuerike), ku janë përpunuar dhe analizuar më tej. Të gjitha gabimet e specifikimit, gabimet e kontrollit dhe gabimet gjatë tabulimit janë adresuar para se të gjenerohen të gjeturat përfundimtare.

3. Të gjeturat e anketës

Kjo pjesë shpalosë gjetjet kryesore të gjeneruara nga anketa me akterët kryesorë të ofertës së turizmit, duke përfshirë: akomodimet me restaurante, akomodimet, restorantet, operatorët e atraksioneve turistike, operatorët turistikë dhe festivalet/ngjarjet kombëtare për vitin 2023. Poashtu, kjo pjesë krahason gjetjet me ato të viteve të mëparshme. Vlenë të theksohet se ndryshimet vjetore duhet të interpretohen me kujdes, pasi që ato mund të jenë rezultat i ndryshimeve në strukturën e mostrës. Të gjeturat kapin aspekte të ndryshme të brendshme dhe të jashtme, siç janë: struktura e përgjithshme e akterëve kryesorë të ofertës së turizmit; struktura e vizitorëve dhe sjellja e tyre; ndryshimet e qarkullimit përgjatë viteve; çështjet e lidhura me punësim; lloji i shërbimeve të ofruara; pengesat e të bërit biznes; dhe pjesëmarrja e akterëve të ofertës së turizmit në botën digjitale. Megjithatë, vlen të përmendet, që këto tema nuk mund të zbatoheshin në të gjitha rastet për shkak të natyrës specifike të disa ofruesve të shërbimeve.

3.1. Akomodimet me restorante¹

Struktura e përgjithshme e akomodimeve me restorante



Në vitin 2023, hotelet përbënin 92 përqind nga të gjitha akomodimet me restorante. Pjesa tjetër ishte e përbërë nga bujtinat (1.3 përqind) dhe lloje të tjera akomodimi (6.7 përqind). Siç shihet në figurën 1, historikisht hotelet kanë dominuar në këtë kategori, me nivelin më të lartë prej 95.7% në vitin 2022 dhe më të ulët 79.3% në vitin 2017. Nga ana tjetër, bujtinat dhe llojet e tjera të akomodimit kanë pasur një

¹ Kjo përfshin të gjitha akomodimet që kanë një restorant ngjitur me biznesin e tyre.

pjesë relativisht më të vogël gjatë viteve, me ndryshime të vogla në përqindje nga viti 2017 deri në vitin 2023.

Numri i dhomave, çmimeve dhe shkalla e shfrytëzimit të banimit

Në vitin 2023, numri mesatar i dhomave standarde njëshe në akomodime me restorante ishte 12.8 dhoma. Për dhomat standarde dyshe, mesatarja ishte më e lartë, 15.9 dhoma. Numri i përgjithshëm i dhomave standarde njëshe (të përshtatura për përfshirjen e të gjithë popullacionit) arriti në 775 dhoma, ndërsa numri i përgjithshëm i dhomave standarde dyshe ishte 1,673 sosh. Për më tepër, siç tregon tabela 2, ka një zhvendosje në mesataren e çmimeve ndërmjet viteve 2022 dhe 2023. Për dhomat standarde dyshe, çmimi mesatar është rritur nga 56.8 euro në vitin 2022 në 60.9 euro në vitin 2023, ndërsa dhomat standarde treshe kanë pasur rritje më të vogël të çmimeve, duke u rritur nga 78.3 euro në 79.3 euro gjatë të njëjtës periudhë kohore. Për informacione në lidhje me llojet e tjera të dhomave dhe për krahasime me vitet e mëparshme, referojuni tabelës 2.

Tabela 2: Akomodimet me restorante - numri mesatar dhe çmimi i dhomave standarde								
		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Dhoma standarde njëshe	Mesatarja (Mes.) # e dhomave	10.9	11.1	9.2	10.6	9.8	10.2	12.8
	Mes. e çmimeve (EURO)	40.1	39.4	39.4	39.3	45.0	50.3	50.4
	Totali # i dhomave	1,035	1,109	1,171	1,015	824	754	775
Dhoma standarde dyshe	Mes. # e dhomave	13.2	14.0	11.3	12.9	16.0	13.6	15.9
	Mes. e çmimeve (EURO)	45.8	48.6	54.2	51.1	53.5	56.8	60.9
	Totali # i dhomave	1,671	1,870	1,504	1,477	1,727	1,661	1,673
Dhoma standarde treshe	Mes. # e dhomave	4.2	4.4	6.8	6.6	6.0	8.6	5.2
	Mes. e çmimeve (EURO)	53.1	52.8	69.6	61.2	75.0	78.3	79.3
	Totali # i dhomave	274	335	636	522	456	790	419
Dhoma standarde katërshe	Mes. # e dhomave	2.6	2.4	2.8	2.1	3.2	3.8	2.4
	Mes. e çmimeve (EURO)	49.5	68.8	91.5	65.7	118.1	125.1	117.9
	Totali # i dhomave	62	63	77	58	130	150	148


Zbërthimi i gjetjeve nga tri rajonet kryesore², tregon se Prishtina ka numrin më të lartë të dhomave standarde njëshe dhe të dhomave standarde dyshe, si dhe çmimet mesatare më të larta. Për informata më të detajuara dhe për të bërë krahasime me vitet paraprake, shih tabelën 3.

Tabela 3: Akomodimet me restorante – dhomat standarde, nga rajonet kryesore													
		Rajoni i Prishtinës (2019)	Rajoni i Prishtinës (2021)	Rajoni i Prishtinës (2022)	Rajoni i Prishtinës (2023)	Rajoni i Pejës (2019)	Rajoni i Pejës (2021)	Rajoni i Pejës (2022)	Rajoni i Pejës (2023)	Rajoni i Prizrenit (2019)	Rajoni i Prizrenit (2021)	Rajoni i Prizrenit (2022)	Rajoni i Prizrenit (2023)
Dhoma standarde njëshe	Mes. e çmimeve (EURO)	52.2	52.5	60.1	63.9	34.8	41.1	44.3	46.3	27.8	39.4	46.8	44.2
	Totali # i dhomave	516	498	512	436	94	150	144	132	225	135	145	243


² Rajonet e tjera nuk kanë mundur të merren parasysh këtu, për shkak të numrit të vogël të vëzhgimeve.

Dhoma standarde dyshe	Mes. e çmimeve (EURO)	66.1	68.8	72.5	73.7	39.9	49.1	52.1	59.53	37.3	46.2	57.3	59.4
	Totali # i dhomave	888	945	899	835	218	261	246	230	368	456	488	439


Shkalla e shfrytëzimit të banimit në vitin 2023 tregon një trend të qëndrueshëm, mesatarisht rreth 56.5 përqind në fund të vitit, me luhatje në baza mujore. Muaji mars kishte normën më të ulët të shfrytëzimit të banimit (42.1 përqind), ndërsa normën më të lartë e kishte në muajin gusht (73.3 përqind).



Gjatë vitit 2023 vërehet një trend si rezultat i sezonalitetit, me nivele maksimale të shfrytëzimit të banimit përgjatë muajve të verës dhe norma minimale përgjatë muajve të dimrit. Për më shumë detaje, shih figurën 4.



Norma mesatare e shfrytëzimit të banimit duket të jetë e ngjashme në të gjitha rajonet kryesore në vitin 2023. Për informacione të detajuara, shih figurën 5.



Struktura e vizitorëve dhe sjellja e tyre

Anketa, gjithashtu analizon strukturën e vizitorëve dhe kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre. Vizitorët ndërkombëtarë përbëjnë 4.0 përqind të vizitorëve të përgjithshëm; diaspora, 23.4 përqind; vizitorët e brendshëm vendorë (që udhëtojnë mbi 20 km), 15.6 përqind; dhe vizitorët lokal (që udhëtojnë më pak se 20 km), 19.0 përqind. Për të bërë krahasime me vitet paraprake, shih figurën 6. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në vitin 2023 ishte 3.2 netë, që është më e lartë në krahasim me vitin 2022 (2.9 netë).





Figura 7 paraqet numrin mesatar të vizitorëve në baza mujore, në kategorinë e akomodimeve me restaurante nga viti 2017 deri në vitin 2023, me fokus veçanërisht në muajt e verës. Siç shihet në figurën më poshtë, në vitin 2023 numri mesatar i vizitorëve në ditë, në këtë kategori të akomodimit është rritur në 492.2 vizitorë në ditë në muajin gusht, duke tejkalluar numrin e vizitorëve në muajin gusht të vitit 2022, që ishte 291.9 vizitorë. Figura 6 paraqet vizualisht mesataret e detajuara për shtatë vitet e kaluara.

Në vitin 2023, pjesa e vizitorëve që kanë ardhur për ushqim dhe pije është rritur me 62.4 përqind nga 61.8 përqind në vitin 2022. Për më tepër, fatura mesatare për këtë kategori në vitin 2023 është rritur në 15.73 euro, nga 13.9 euro një vit më parë. Nga ana tjetër, përqindja e atyre që kanë ardhur për pije është ulur pak në 37.54 përqind në vitin 2023, krahasuar me 38.0 përqind në vitin 2022, pavarësisht rritjes së faturës mesatare nga 4.1 euro në vitin 2022 në 5.5 euro në vitin 2023.


Figura 7: Numri mesatar i vizitorëve në akomodime me restaurante, në baza mujore (2017-2023)



Qarkullimi dhe investimet


Sa i përket qarkullimit, shumica dërrmuese - 78.8 përqind - raportuan të kenë performuar ‘më mirë’ ose ‘shumë më mirë’ krahasuar me vitin 2022; 8.2 përqind deklaruan se nuk kanë pasur asnjë ndryshim, dhe vetëm 8.2 përqind deklaruan se kanë pasur një performancë ‘shumë më të keqe’ (shih figurën 8).

Figura 8: Ndryshimet në qarkullim krahasuar me vitin 2022 për akomodimet me restaurante (%)




Një analizë e mëtejshme shpalosë se në vitin 2023, ‘shërbimet e akomodimit’ kanë kontribuar me 52.3 përqind në qarkullimin e përgjithshëm; ‘ushqimi dhe pijet’ me 25.9 përqind; ‘dasmat dhe ahengjet e tjera familjare’ me 13.3 përqind; ‘konferencat dhe mbledhjet’ me 5.5 përqind. Për të nxjerrë një krahasim me vitin paraprake, shih figurën 9.

Figura 9: Qarkullimi sipas llojit të shërbimit (në %) për akomodimet me restaurante (2017-2023)



Nga kategoria e akomodimeve me restaurante 53.9 përqind e të anketuarve, deklaruan se kanë bërë një lloj investimi në vitin në vitin 2023, krahasuar me 27.9 përqind në vitin 2022. Në vitin 2023, investimet e tyre janë financuar kryesisht nga kursimet vetanake (50.0 përqind) dhe bankat (29.5 përqind). Për të parë burimet e tjera të investimeve dhe për t'i krahasuar ato me vitet paraprake, referojuni figurës 10.


Figura 10: Burimet e investimeve (%) për akomodimet me restaurante (2017-2023)



Shërbimet e ofruara

Në pyetjen lidhur me shërbimet e ofruara përgjatë vitin 2023, përgjigjet më të shpeshta ishin: shërbimet e lavanderisë (69.0 përqind të rasteve), shërbime për udhëzues/guida turistike (39.7

përqind) dhe shërbimet për pishinë (29.3 përqind). Për llojet e tjera të shërbimeve të ofruara nga akomodimet me restorante në vitin 2023, si dhe shërbimet e ofruara në vitet paraprake, shih figurën 11.




Punësimi


Duke e ditur rëndësinë e sektorit të turizmit në punësim, përpjekje shtesë i është kushtuar këtij nën-seksioni. Për të gjeneruar numrin e përgjithshëm të punëtorëve në kategorinë e akomodimeve me

restorante është përdorur metoda e peshimit (ponderimit) në bazë të popullacionit. Të dhënat e mostrës janë shumëzuar me faktorin bruto prej 1.423 - që do të thotë se popullacioni përfshin 42.3 përqind më shumë subjekte. Është thelbësore të theksohet se gjatë llogaritjes së faktorit, janë marrë në konsideratë të gjitha akomodimet me restorante të listuara në Booking.com, TripAdvisor, Gjirafa si dhe në platforma të tjera të ngjashme. Ky është identifikuar si një popullacion i vlefshëm turistik nga hulumtuesit dhe ekipi i PPSE-së. E njëjta logjikë është aplikuar për akomodimet (pa restorante) dhe restorantet. Kjo qasje është aplikuar vazhdimisht për vitin e shtatë radhazi, duke lejuar krahasime në baza vjetore. Nga ana tjetër, kjo qasje nuk mund të zbatohet për operatorët e atraksioneve turistike dhe operatorët turistikë për shkak të mungesës së të dhënave për madhësinë e popullacionit. Sidoqoftë, karakteristikat demografike të punëtorëve janë përshkruar në secilin rast.

Të gjeturat e punësimit tregojnë se në shtatë vitet e fundit, numri i punëtorëve në akomodime me restorante ka shënuar rritje me rreth 70.2 përqind (shih, figurën 12). Rritja e punësimit ka ndjekur trendin e viteve para pandemisë.



Zbërthimi i gjetjeve nga tre rajonet kryesore tregon se në vitin 2023, akomodimet me restorante në rajonin e Prishtinës kishin numrin më të madh të punësuarve, me gjithsej 1,696 të punësuar në total. Numri i të punësuarve në rajonin e Pejës dhe të Prizrenit ishte dukshëm më i vogël, 590 përkatësisht 437 punëtorë. Në të gjitha rastet, ka pasur rritje të dukshme krahasuar me vitin 2022 (shih figurën 13).



Në vijim janë disa karakteristika demografike për punëtorët e punësuar në akomodime me restorante në vitin 2023. Burrat dominojnë me 72.3 përqind. Nga të gjithë të punësuarit, vetëm 24.6 përqind punojnë me orar të pjesshëm. Një zbërthim i të dhënave sipas përkatësisë etnike, tregon se punëtorët janë kryesisht shqiptarë të Kosovës - 94.2 përqind; pjesa tjetër përbëhet nga boshnjakë me 2.6 përqind; turq me 1.5 përqind; RAE me 0.5 përqind; dhe të tjerë, 0.1 përqind. Grupmoshat ndërmjet 25-44 vjeçare, përbëjnë shumicën me 61.6 përqind. Për informata më të detajuara dhe për të bërë krahasime me demografinë e punësimit me shtatë vitet paraprake, shih tabelën 4.

Tabela 4: Demografia e punësimit						
2017						
Gjinia	Burra			Gra		
	61.5%			38.5%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)		Punë me orar të pjesshëm (gra)
	51.6%		9.9%	34.2%		4.3%
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	94.4%	2.5%	1.0%	0.7%	1.5%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	16.3%	40.4%	24.8%	15.5%	2.9%	0.1%
2018						
Gjinia	Burra			Gra		


		63.8%			36.2%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)		
	55.9%		7.9%	33.3%	2.9%		
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë	
	95.9%	1.4%	0.9%	0.7%	1.0%	0.0%	
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<	
	19.0%	35.7%	30.3%	12.4%	2.3%	0.2%	
2019							
Gjinia	Burra			Gra			
	62.2%			37.8%			
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)		
	56.6%		5.6%	34.3%	3.5%		
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë	
	96.8%	1.2%	0.7%	0.5%	0.5%	0.3%	
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<	
	23.4%	37.1%	28.4%	8.4%	2.6%	0.1%	
2020							
Gjinia	Burra			Gra			
	61.5%			38.5%			
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)		
	54.3%		7.2%	34.5%	4.0%		
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë	
	93.6%	1.4%	1.3%	0.8%	1.1%	1.8%	
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<	
	26.0%	36.0%	22.3%	12.4%	3.0%	0.2%	
2021							
Gjinia	Burra			Gra			
	62.5%			37.5%			
Punë me orar të plotë vs. punë me	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)		

orar të pjesshëm	53.8%		8.7%	33.9%		3.6%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë	
	93.0%	0.1%	2.1%	0.9%	3.8%	0.1%	
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<	
	19.2%	30.2%	35.2%	10.5%	4.2%	0.6%	
2022							
Gjinia	Burra			Gra			
	78.5%			21.5%			
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)		
	53.8%		24.8%	16.9%	4.5%		
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë	
	95.6%	0.0%	1.8%	0.2%	2.2%	0.2%	
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<	
	15.6%	32.5%	33.9%	14.0%	3.8%	0.2%	
2023							
Gjinia	Burra			Gra			
	72.3%			27.7%			
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)		
	47.6%		24.6%	21.0%	6.7%		
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë	
	94.2%	1.1%	1.5%	0.5%	2.6%	0.1	
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<	
	18.21%	29.55%	32.14%	15.41%	4.27%	0.42%	


Pengesat e të bërit biznes

Akomodimeve me restorante iu është dhënë një listë me 12 pengesa të mundshme (kryesisht pengesa të jashtme) dhe iu është kërkuar të zgjedhin ato më të rëndat. ‘Përpjekjet e ulëta të qeverisë’ me 44.1 përqind, pasur nga ‘promovimi i ulët i rajonit’ me 44.1 përqind janë konsideruar si pengesat më të rënda nga të anketuarit në vitin 2023. Pengesat e tjera si ‘mungesa e financave’ dhe ‘mundësitë e kufizuara të rrjetëzimit’ mbetën shqetësime në të dy vitet, me një rritje të konsiderueshme nga 22.9 përqind në vitin 2022 në 33.8 përqind në vitin 2023 dhe nga 28.6 përqind në vitin 2022 në 33.8 përqind në vitin 2023.

Për informacione më të detajuara dhe për të bërë krahasime me shtatë vitet e mëparshme, shih figurën 14.



Për të kuptuar nëse akomodimet me restorante janë në hap me trendet e fundit të dixhitalizimit, si dhe për të vlerësuar efikasitetin me të cilin po i përdorin mjetet dixhitale për të rritur efikasitetin operacional, anketa ka përfshirë një sërë pyetjesh për këtë çështje. Sipas të dhënave në vitin 2023, 78.2 përqind e akomodimeve me restorante kishin uebfaqet e tyre. Për më tepër, shumica dërrmuese, 93.3 përqind, deklaruan se përdorin rrjetet sociale (kryesisht Facebook) për të promovuar biznesin e tyre. Kur u pyetën për rezervimet online, 86.1 përqind deklaruan se e kishin këtë opsion. Shumica e rezervimeve bëhen përmes booking.com. Për të bërë krahasime me shtatë vitet e mëparshme, referojuni figurës 15.





3.2. Akomodimet (pa restorante)³

Struktura e përgjithshme

Në vitin 2023, nga të gjitha akomodimet, hotelet mbizotëruan me 50.0 përqind, pasuar nga bujtinat/vilat/shtëpitë njëkatëshe malore (ang. bungalow) me 20.3 përqind, apartamentet Airbnb me 12.2 përqind dhe bujtinat me 10.8 përqind. Për të bërë krahasime me vitet paraprake, shih figurën 16. Shumica dërrmuese e këtyre akomodimeve gjenden në Pejë (39.2 përqind), Prishtinë (37.2 përqind); dhe Ferizaj (5.4 përqind); siç paraqitet në figurën 17.

³ Ndryshe nga nën-seksioni i mëparshëm, kjo pjesë paraqet të gjeturat e subjekteve që ofrojnë shërbime vetëm të akomodimit (pa restorante).



Numri i dhomave, çmimet dhe shkalla e shfrytëzimit të banimit

Rezultatet e anketës tregojnë se në vitin 2023, mesatarisht akomodimet kishin 7.3 dhoma standarde njëshe dhe 10.3 dhoma standarde dyshe. Në të njëjtin vit, numri i përgjithshëm i dhomave standarde njëshe dhe dyshe (të përshtatura për përfshirjen e të gjithë popullacionit) ishte 315 dhoma. Veçanërisht, çmimet e dhomave janë rritur në të gjitha kategoritë në vitin 2023 krahasuar me vitet e mëparshme. Rrjedhimisht, çmimi mesatar për një dhomë standarde njëshe është rritur nga 33.9 euro në vitin 2022

në 36.7 euro në vitin 2023. Në mënyrë të ngjashme, çmimi mesatar për një dhomë dyshe është rritur nga 47.1 euro në 51.4 euro në vitin 2023. Rritja më e madhe e çmimit ishte për dhomat standarde me katër krevate, të cilat janë rritur nga 65.1 euro në vitin 2022 në 91.3 euro në vitin 2023. Për informacione më të detajuara rreth numrit mesatar të dhomave dhe çmimeve, si dhe për të bërë krahasime me vitet e mëparshme, referojuni tabelës 5.

Tabela 5: Akomodimet - Numri mesatar dhe çmimi i dhomave standarde		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Dhoma standarde njëshe	Mesatarja (Mes.) # e dhomave	10.05	8.6	9.1	7.2	7.9	6.1	7.3
	Mes. e çmimeve (EURO)	27.3	25.0	24.6	24.6	36.3	33.9	37.6
	Totali # i dhomave	582	680	678	541	481	334	315
Dhoma standarde dyshe	Mesatarja (Mes.) # e dhomave	7.6	8.3	10.5	10.6	8.8	8.1	10.3
	Mes. e çmimeve (EURO)	31.7	32.4	34.3	30.9	40.9	47.1	51.4
	Totali # i dhomave	573	923	986	859	754	627	646
Dhoma standarde treshe	Mesatarja (Mes.) # e dhomave	3.0	4.7	6.9	7.0	3.7	5.4	7.2
	Mes. e çmimeve (EURO)	43.6	40.1	45.7	34.5	50.0	60.9	66.1
	Totali # i dhomave	127	263	380	360	263	350	339
Dhoma standarde katërshe	Mesatarja (Mes.) # e dhomave	1.9	5.3	5.7	2.9	3.8	5.2	6.4
	Mes. e çmimeve (EURO)	49.9	50.3	62	44.9	60.8	65.1	91.3
	Totali # i dhomave	70	127.3	174	115	96	192	160

Në vitin 2023, shkalla e shfrytëzimit të banimit e kësaj kategorie ka qenë mesatarisht 57.2 përqind. Norma më e lartë ka qenë në muajin gusht (80.7 përqind), ndërsa norma më e ulët në muajin mars (41.5 përqind). Për rezultate më të detajuara dhe për të bërë krahasime me vitet paraprake, shih figurën 18.





Figura 19 ilustron shkallën e shfrytëzimit të banimit (%) për akomodime përgjatë gjithë muajve të vitit 2023. Siç vërehet, niveli maksimal i shfrytëzimit të banimit ndodh përgjatë muajve korrik (78.3%) dhe gusht (80.7%), për shkak të turizmit veror.


Figura 19. Shkalla e shfrytëzimit të banimit (në %) për akomodimet, përgjatë gjithë muajve në vitin 2023



Struktura e vizitorëve dhe sjellja e tyre

Sipas të dhënave, në vitin 2023, vizitorët nga diaspora përbënin 35,7 përqind nga të gjithë vizitorët në akomodimet pa restorante, pasuar nga vizitorët ndërkombëtarë, 25,1 përqind; vizitorët lokal me 24,6 përqind, dhe vizitorët e brendshëm vendorë (që udhëtojnë mbi 20 km) me 14,5 përqind. Për të krahasuar të dhënat me vitet e mëparshme, referojuni figurës 20. Numri i netëve të kaluara ishte mesatarisht 6.7 netë në vitin 2023, që është më i lartë se ai i vitit 2022 (5.6 netë).


Figura 20: Struktura e vizitorëve sipas origjinës (në %) për akomodimet (2017-2023)



Të hyrat dhe investimet


Të gjeturat nga të hyrat tregojnë se në vitin 2023, 40.8 përqind e akomodimeve raportuan se kanë operuar 'shumë më mirë'; 39.4 përqind kanë operuar 'më mirë', ndërsa 15.5 përqind 'nuk kanë pasur ndonjë ndryshim' krahasuar me vitin 2022 (shih, figurën 21).

Figura 21: Ndryshimi në qarkullim (në %) për akomodimet në krahasim me vitin 2022



Në përgjigje të pyetjes nëse kanë investuar në biznesin e tyre në vitin 2023, 59.6 përqind e akomodimeve kanë thënë 'po'. Ato/ata që kanë investuar, janë financuar kryesisht nga kursimet e tyre vetanake (51.7 përqind). Megjithatë, në vitin 2023, përqindja e bizneseve që përdorin kredi për të financuar investimet e tyre është rritur nga 28.6 përqind në 34.5 përqind. Për të parë burimet e tjera të financimit dhe për të bërë krahasime me vitet e mëparshme, referojuni figurës 22.


Figura 22: Burimet e investimeve (në %) për akomodimet (2017-2023)



Shërbimet e ofruara

Akomodimeve, poashtu iu është dhënë një listë me shërbime të zakonshme dhe iu është kërkuar që të zgjedhin ato shërbime të cilat i kanë ofruar. Të gjeturat tregojnë, se shërbimet e lavanderisë (80.0 përqind), shërbimet për udhëzues/guida turistike (26.7 përqind) shërbimet e transportit (35.6 përqind) ishin shërbimet më të zakonshme të ofruara nga akomodimet në vitin 2023. Për të parë shërbimet e tjera të ofruara në vitin 2023 dhe për të bërë krahasime me vitet paraprake, referojuni figurës 23.

Figura 23: Shërbimet e ofruara në akomodime (në % të rasteve, 2017-2023)




Të gjeturat më tej paraqesin se vetëm 10.0 përqind e akomodimeve kishin pako speciale (d.m.th. pako për fundjavë ose pushime) në vitin 2023, krahasuar me 18.7 përqind në vitin 2022.

Punësimi

Në vitin 2022, numri i punëtorëve në akomodime ishte 1,213 më shumë se dyfishi krahasuar me vitin 2017 (shih figurën 24)⁴. Punësimi është rritur çdo vit me përjashtim të vitit 2020, ku pati një rënie për shkak të kufizimeve të vendosura për të frenuar përhapjen e pandemisë Covid-19.

⁴ Faktori bruto për akomodime~1.423



Më poshtë janë disa të dhëna demografike të punësimit për akomodime në vitin 2023. Burrat përbëjnë shumicën (56.9 përqind) e punëtorëve. Nga të gjithë punëtorët, vetëm 10.2 përqind punojnë me orar të pjesshëm. Një zberthim i të dhënave sipas përkatësisë etnike, tregon se pothuajse të gjithë punëtorët ishin shqiptarë të Kosovës – 98.6 përqind. Grupmoshat ndërmjet 25-44 vjeçare përbënin shumicën e punëtorëve me 68.9 përqind. Për informata më të detajuara dhe për të bërë krahasime me vitet paraprake, shih tabelën 6.

Tabela 6: Demografia e punësimit (Akomodimet)						
2017						
Gjinia	Burra			Gra		
	65.5%			34.4%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)		Punë me orar të pjesshëm (gra)
	51.4%		14.2%	28.9%		5.5%
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	99.1%	0.0%	0.0%	0.4%	0.5%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	13.8%	42.5%	28.3%	13.2%	1.7%	0.4%
2018						
Gjinia	Burra			Gra		
	62.8%			37.2%		
Punë me orar të	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)		Punë me orar të pjesshëm (gra)


plotë vs. punë me orar të pjesshëm	50.2%		12.6%	31.8%	5.4%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	99.4%	0.0%	0.2%	0.4%	0.0%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	15.3%	48.7%	22.1%	12.1%	0.6%	1.2%
2019						
Gjinia	Burra			Gra		
	71.7%			28.3%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	62.0%		8.5%	26.8%	1.5%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	98.6%	0.0%	0.5%	0.3%	0.3%	0.3%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	13.1%	51.5%	25.2%	8.9%	1.3%	0.0%
2020						
Gjinia	Burra			Gra		
	67.8%			32.2%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	61.7%		6.0%	30.5%	1.7%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	98.4%	0.0%	0.2%	0.7%	0.7%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	11.4%	44.8%	27.0%	13.4%	3.5%	0.0%
2021						
Gjinia	Burra			Gra		
	62.5%			37.5%		
Punë me orar të	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	

plotë vs. punë me orar të pjesshëm	54.5%		8.0%	35.4%	2.1%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	96.7%	0.2%	0.6%	1.0%	1.5%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	16.9%	32.0%	25.4%	17.8%	7.4%	0.4%
2022						
Gjinia	Burra			Gra		
	74.4%			25.6%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	45.8%		28.6%	14.3%	11.3%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	98.1%	0.0%	0.9%	0.5%	0.5%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	16.1%	44.9%	24.8%	11.0%	2.8%	0.4%
2023						
Gjinia	Burra			Gra		
	56.9%			43.1%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	46.7%		10.2%	38.5%	4.6%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	98.6%	0.0%	0.0%	0.1%	0.3%	1.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	18.5%	33.2%	37.7%	9.3%	1.1%	0.2%

Pengesat e të bërit biznes

Akomodimet janë pyetur gjithashtu për të zgjedhur pengesat më shtrënguese për të bërë biznes. 'Promovimi i ulët i rajonit' (39.4 përqind), 'përpyjekjet e ulëta të qeverisë' (39.4 përqind) dhe 'problemet me energjinë elektrike' (22.5 përqind) ishin perceptuar si pengesat më shtrënguese operative sipas akomodimeve përgjatë vitit 2023. Për të parë pengesat e tjera për të bërë biznes dhe për t'i krahasuar ato me vitet paraprake, referojuni figurës 25.


Figura 25: Pengesat e të bërit biznes në akomodime (në % të rasteve, 2017-2023)



Dixhitalizimi

Të gjeturat e anketës paraqesin se 60.0 përqind e akomodimeve kishin uebfaqet e tyre në vitin 2023. Shumica dërmuese ose 87.3 përqind ishin të regjistruar në Google Maps. Një përqindje e ngjashme,


85.5 përqind, pohuan se përdorin mediat sociale për të promovuar akomodimin e tyre. Për t'i krahasuar të dhënat me vitet paraprake, shih figurën 26.



3.3. Restorantet

Struktura e përgjithshme


Në vitin 2023, Prishtina dominoi me 34.6 përqind nga të gjitha restorantet në Kosovë, pasuar nga Gjilani me 11.4 përqind, Prizreni me 10.9 përqind dhe Ferizaj me 9.0 përqind - shih figurën 27.



Vizitorët dhe sjellja e tyre


Të dhënat tregojnë se restorantet kanë pasur mesatarisht 320,9 vizitorë në ditë në vitin 2023, duke shënuar një rritje prej 18,8 përqind krahasuar me vitin 2022. Gushti spikati si muaji më i ngarkuar, me një mesatare prej 480,5 vizitorë në ditë. Për informacione më të detajuara dhe për të krahasuar mesataret me ato të viteve të mëparshme, referojuni figurës 28.

Figura 28: Mesatarja e vizitorëve në baza ditore në restorante (2017-2023)



Për informacione më të detajuara në lidhje me mesataren e vizitorëve në baza ditore në restorante përgjatë vitit 2023, shih figurën 29.


Figura 29: Mesatarja e vizitorëve në baza ditore në restorante (2017-2023)



Gjetjet tregojnë se në vitin 2023, 54.6 përqind e klientelës në restorante përbëhej nga vizitorët lokal; të tjerët përfshinin diasporën (18.2 përqind), vizitorët e brendshëm vendorë (që udhëtojnë mbi 20 km) (17.8 përqind) dhe ndërkombëtarët (9.4 përqind). Për të bërë krahasime me vitet e mëparshme, shihni figurën 30.


Për më tepër, të dhënat tregojnë një trend të qëndrueshëm të preferencave të vizitorëve: në vitin 2023, 60.9 përqind (59.8 përqind në vitin 2022) e të gjithëve vizitorëve shkuan në restorante për

ushqim dhe pije, ndërsa pjesa tjetër vetëm për pije. Për më tepër, është vërejtur një rritje e dukshme e çmimit mesatar për porosi. Të ftuarit që konsumojnë të dyja, ushqim dhe pije shpenzuan mesatarisht 11.3 euro, që krahasuar me vitin 2022 është më e lartë (8.9 euro në vitin 2022), Po kështu, vizitorët që kanë ardhur vetëm për pije shpenzuan mesatarisht 4.2 euro, nga 3.9 euro në vitin e kaluar.




Të hyrat dhe investimet


Në lidhje me pyetjen për ndryshimet në qarkullim në krahasim me vitin 2023, 63.4 përqind e restoranteve raportojnë të kenë performuar 'më mirë' ose 'shumë më mirë'; nga ana tjetër, 7.6 përqind e tyre deklarojnë se kanë përjetuar të kundërtën; pjesa tjetër thonë se nuk kanë përjetuar asnjë ndryshim në qarkullimin (shih, figurën 31).



Një analizë e mëtejme mbi përbërjen e qarkullimit vjetor tregon se në vitin 2023, ushqimi dhe pijet përbënin burimin kryesor të të ardhurave për restorantet me 85.6 përqind, pasuar nga shërbimet e dërgesave me 6.4 përqind, dasmat dhe ahengjet familjare me 5.2 përqind, konferencat dhe mbledhjet me 2.3 përqind. Për më shumë detaje, shih figurën 32.



Restorantet që investuan në vitin 2023, investimet e tyre i kanë bërë kryesisht nga ‘paratë vetanake’ (52.7 përqind). Për të parë burimet e tjera të financimit dhe për të bërë krahasime me vitet e mëparshme, shih figurën 33.




Punësimi

Punësimi në restorante ka qenë më i larti në shtatë vitet e fundit, duke arritur në 9,705 të punësuar, që shënon rritje me 56.4 përqind krahasuar me vitin 2015 (shih figurën 34).⁵


⁵ Faktori bruto për restorantet ~2.1644

Figura 34: Restorantet - Numri i punëtorëve, ndër vite (2015-2023)



Zbërthimi i të dhënave nga rajonet kryesore, tregon se rajoni i Prishtinës përbën numrin më të madh të të punësuarve në restorante në vitin 2023 me (7,242 punëtorë), pasuar nga Gjilani me (1,325) dhe Peja me (975 punëtorë). Në të gjitha rastet, numri i punëtorëve është më i larti në shtatë vitet e fundit, duke iu referuar figurës 35.

Figura 35: Restorantet - Numri i punëtorëve (2017-2023), sipas rajoneve




Më poshtë janë disa demografi të punësimit për restorante. Nga të gjithë të punësuarit, pjesa dërrmuese janë burra – 70.4 përqind. Shumica e punëtorëve ose 58.8 përqind punojnë me orar të plotë. Një përqindje e papërfillshme (2.7 përqind) përbëhet nga punëtorë jo-shqiptarë të Kosovës. Grupmoshat ndërmjet 15-34 vjeçare përbëjnë grupin më të zakonshëm me 72.08 përqind. Për më shumë informata dhe për të bërë krahasime me vitet paraprake, shih tabelën 7.

Tabela 7: Demografia e punësimit (Restorantet)						
2017						
Gjinia	Burra			Gra		
	74.4%			25.6%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	63.2%		11.2%	21.3%	4.3%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	98.9%	0.1%	0.5%	0.2%	0.3%	0.1%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	34.1%	42.0%	19.0%	4.1%	0.9%	0.0%
2018						
Gjinia	Burra			Gra		
	78.7%			21.5%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	63.2%		15.2%	18.9%	2.6%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	98.2%	0.3%	0.5%	0.5%	0.5%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	23.8%	55.2%	16.3%	3.9%	0.7%	0.0%
2019						
Gjinia	Burra			Gra		
	77.5%			22.5%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	71.7%		5.8%	19.6%	2.8%	

Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
		98.1%	0.2%	0.4%	0.6%	0.6%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	22.0%	48.4%	20.3%	7.9%	1.4%	0.0%
2020						
Gjinia	Burra			Gra		
	76.2%			23.8%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	67.2%		9.0%	21.7%	2.1%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	98.5%	0.1%	0.4%	0.5%	0.4%	0.1%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	24.3%	46.2%	19.9%	8.2%	1.2%	0.2%
2021						
Gjinia	Burra			Gra		
	74.3%			25.7%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	59.6%		14.7%	21.1%	4.6%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	96.4%	0.1%	1.3%	0.3%	1.8%	0.1%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	29.7%	42.9%	17.9%	7.4%	2.1%	0.1%
2022						
Gjinia	Burra			Gra		
	75.7%			24.3%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	57.1%		18.7%	19.9%	4.4%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë


	97.400%	0.3%	1.2%	0.3%	0.7%	0.1%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	28.0%	41.8%	19.2%	8.3%	2.7%	0.0%
2023						
Gjinia	Burra			Gra		
	70.4%			29.6%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	58.8%		11.6%	25.4%	4.3%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	97.31%	0.18%	1.36%	0.80%	0.30%	0.06%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	26.07%	46.01%	19.31%	6.87%	1.70%	0.04%

Ngjashëm si në anketën e fundit, restoranteve iu është kërkuar të ndajnë mendimin e tyre në lidhje me deklaratën e mëposhtme: 'Punonjësit e mi kanë arsimim të mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e punës'. Rezultoni se në vitin 2023, 95.6 përqind 'pajtohen plotësisht' ose 'pajtohen' me këtë deklaratë, ndërsa pjesa tjetër mendonin të kundërtën. Shih figurën 36, për të bërë krahasime me vitet paraprake lidhur me këtë deklaratë.



Furnizimi


Në përgjigje të pyetjes lidhur me origjinën e furnizimeve në vitin 2023, 51.4 përqind e restoranteve mendojnë se produktet kanë origjinë vendore, krahasuar me 50.5 në vitin 2022. Furnizimet për restorantet e tyre në vitin 2023 kryesisht bëheshin nga tregtarët me shumicë dhe në supermarkete. Një e gjetur tjetër, pasqyron se në përgjithësi restorantet kanë qenë të kënaqura me furnizuesit; 89.2 përqind e restoranteve deklaruan se kanë qenë ‘të kënaqur’ ose ‘shumë të kënaqur’ me furnizuesit e tyre në vitin 2023. Për më shumë informata mbi nivelin e kënaqshmërisë me furnizuesit si dhe për të bërë krahasime me vitet paraprake, referojuni figurës 37.



Pengesat e të bërit biznes


Pengesat e mundshme për të bërë biznes gjithashtu janë testuar edhe me restorante. Në vitin 2023, rezulton se ‘përpjekjet e ulëta të qeverisë’ me 42.0 përqind; ‘promovimi i ulët i rajonit’ me 36.6 përqind dhe ‘mungesa e financave’ me 39.7 përqind, konsiderohen si pengesat më të rënda operuese nga të anketuarit. Për informata më të detajuara dhe për të bërë krahasime me vitet paraprake, shih figurën 38.

Figura 38: Pengesat e të bërit biznes për restaurantet (në % të rasteve), 2017-2023



Dixhitalizimi


Nga të gjitha restorantet e anketuara, 50.00 përqind kishin uebfaqet e tyre në vitin 2023 dhe 91.0 përqind ishin të regjistruara në Google Maps. Një përqindje më e lartë (93.00 përqind) përdorin mediat sociale për të promovuar shërbimet e tyre. Për t'i krahasuar të dhënat me vitet e mëparshme, referojuni figurës 39.



3.4. Atraksionet

Numri i vizitorëve dhe karakteristikat e tyre

Numri i përgjithshëm i vizitorëve në atraksionet turistike në vitin 2023 ishte 261,966 sosh – një rënie prej 3.64 përqind krahasuar me vitin 2022 (shih figurën 40). Kjo rënie mund të lidhet me faktin se shumë qytetarë po zgjedhin të udhëtojnë jashtë vendit. Për më tepër, duhet theksuar se këto shifra janë marrë ekskluzivisht nga atraksionet që janë intervistuar. Prandaj, ato nuk përfaqësojnë numrin e përgjithshëm të vizitave në vend, por tregojnë një trend. Ky kufizim është për shkak të mungesës së informacioneve të mjaftueshme mbi tablonë e plotë të popullacionit.



Në vitin 2023, struktura e vizitorëve në atraksione përbëhej kryesisht nga vizitorët e brendshëm vendorë (që udhëtojnë mbi 20 km), duke përbërë 47.8 përqind. Ata u pasuan nga vizitorët nga diaspora me 26.3 përqind dhe vizitorët ndërkombëtarë me 26.3 përqind. Për krahasime me vitet e mëparshme, referojuni figurës 41. Gjermanët, shqiptarët, turqit, amerikanët dhe të tjerët përbënin shumicën e vizitorëve, siç paraqitet në figurën 42.

Figura 41: Atraksionet - Struktura e vizitorëve sipas origjinës, 2017-2023 (në %)






Figura 42: Atraksionet sipas origjinës së vizitorëve (2017-2023) (në %)



Lokacioni

Shumica e atraksioneve të anketuara ndodhen në Pejë (27.3 përqind) pasuar nga Prizreni (22.7 përqind), Prishtina (18.2 përqind), Gjakova (13.6 përqind) dhe Mitrovica (4.5 përqind) (shih figurën 43).

Figura 43: Atraksionet, sipas pesë lokacioneve më të mëdha, (në %)



Punësimi

Në vitin 2023, atraksionet kishin staf kryesisht nga punëtorë meshkuj, duke përbërë 83.3 përqind të fuqisë punëtore. Nga totali i punëtorëve të punësuar në atraksione, 73.7 përqind punonin me orar të plotë. Komunitetet jo-shumicë përbënin vetëm 6.9 përqind nga të gjithë punëtorët. Për sa i përket grupmoshës, 59.7 përqind e punëtorëve i përkasin grupmoshës ndërmjet 25-44 vjeç. Për rezultate më të detajuara dhe për të bërë krahasime me të dhënat e viteve të mëparshme, ju lutemi referojuni tabelës 8.


Tabela 8: Demografia e punësimit (Atraksionet)						
2017						
Gjinia	Burra			Gra		
	73.6%			26.4%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	60.0%		13.6%	24.4%	2.0%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	84.3%	13.2%	0.9%	0.9%	0.6%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	13.7%	28.9%	36.5%	14.4%	5.3%	1.1%
2018						
Gjinia	Burra			Gra		
	55.8%			44.2%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	46.9%		0.4%	51.6%	1.1%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	96.4%	0.0%	0.9%	0.9%	1.8%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	4.8%	22.1%	47.1%	19.2%	6.7%	0.0%
2019						
Gjinia	Burra			Gra		
	47.3%			52.7%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	47.8%		8.0%	33.6%	10.6%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë

	96.7%	0.7%	0.4%	0.7%	1.5%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	5.9%	26.2%	38.7%	18.4%	10.5%	0.3%
2020						
Gjinia	Burra			Gra		
	45.6%			54.4%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	45.6%		0.0%	54.4%	0.0%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	97.1%	0.8%	0.4%	0.4%	1.3%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	7.3%	21.5%	35.0%	23.6%	12.6%	0.0%
2021						
Gjinia	Burra			Gra		
	57.1%			42.9%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	57.1%		0.0%	42.9%	0.0%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	95.2%	1.1%	1.1%	0.5%	2.1%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	3.9%	17.2%	33.6%	36.7%	7.0%	1.6%
2022						
Gjinia	Burra			Gra		
	70.5%			29.5%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	58.0%		12.5%	27.8%	1.7%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	93.8%	1.1%	2.3%	0.0%	2.8%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	6.7%	29.3%	28.8%	28.8%	5.3%	1.0%
2023						
Gjinia	Burra			Gra		
	83.3%			16.7%		

Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	63.2%		20.2%	10.5%	6.1%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
		93.0%	3.1%	0.8%	1.5%	1.5%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	6.9%	26.4%	33.3%	27.6%	5.8%	0.0%

Dixhitalizimi

Të gjeturat tregojnë se në vitin 2023, 60.0 përqind e atraksioneve kishin uebfaqet e tyre, ndërsa 100 përqind e të gjitha atraksioneve ishin të regjistruara në Google Maps. Për më tepër, 68.8 përqind pohuan se përdorin rrjetet sociale për qëllime promovuese. Për të bërë krahasime me vitet paraprake, shih figurën 44.




3.5. Operatorët turistikë

Turnetë, çmimet dhe qarkullimi

Në vitin 2023, 76.4 përqind e operatorëve turistikë kanë punuar me turistë nga jashtë që vijnë në Kosovë dhe turistë vendorë që kanë vizituar vendet jashtë Kosovës, ndërsa pjesa tjetër e operatorëve turistikë kanë punuar vetëm me turistë nga jashtë që vijnë në Kosovë. Numri i përgjithshëm i turneve të shitura në vitin 2023 ishte 3,897.

Struktura e vizitorëve

Në vitin 2023, klientela e operatorëve turistikë kryesisht përbëhej nga vizitorët vendorë (31.43 përqind) dhe vizitorëve nga diaspora (30.0 përqind). Për më shumë informata dhe për të bërë krahasime me vitet paraprake, shih figurën 45.



Punësimi

Më poshtë janë disa demografi të punësimit për operatorët turistikë. Numri mesatar i punëtorëve që punojnë për operatorët turistikë ishte 5.6 në vitin 2022, krahasuar me 4.2 në vitin 2021. Të gjeturat tregojnë se në vitin 2022, 67.4 përqind e punëtorëve tek operatorët turistikë janë burra dhe 63.8 përqind e tyre punonin me orar të plotë. Të gjithë punëtorët ishin shqiptarë të Kosovës. Grupmosha ndërmjet 25 dhe 44 vjeçare përbën shumicën e punëtorëve me 83.9 përqind. Për më shumë informata si dhe për të bërë krahasime me vitet paraprake, shih tabelën 9.

Tabela 9: Demografia e punësimit (Operatorët turistikë)						
2017						
Gjinia	Burra			Gra		
	59.2%			40.8%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	23.7%		35.5%	26.0%	14.8%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	96.7%	0.0%	0.8%	0.8%	0.0%	1.7%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	18.9%	52.4%	24.4%	3.7%	0.6%	0.0%
2018						
Gjinia	Burra			Gra		
	69.9%			30.1%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	33.3%		36.6%	16.3%	13.7%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	95.3%	2.0%	2.0%	0.0%	0.7%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	22.2%	56.7%	15.6%	4.4%	1.1%	0.0%
2019						
Gjinia	Burra			Gra		
	52.9%			47.1%		


Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	40.0%		12.9%	38.8%	8.2%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	97.6%	0.0%	1.2%	0.0%	1.2%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	16.4%	58.2%	20.9%	3.0%	1.5%	0.0%
2020						
Gjinia	Burra			Gra		
	44.0%			56.0%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	40.5%		3.6%	48.8%	7.1%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	98.8%	0.0%	1.2%	0.0%	0.0%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	14.7%	57.4%	22.1%	2.9%	2.9%	0.0%
2021						
Gjinia	Burra			Gra		
	52.1%			47.9%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	30.9%		21.3%	30.9%	17.0%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	100.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	10.8%	48.3%	32.5%	8.3%	0.0%	0.0%
2022						
Gjinia	Burra			Gra		
	67.4%			32.6%		

Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	39.9%		27.5%	23.9%	8.7%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	100.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	7.6%	52.5%	31.4%	8.5%	0.0%	0.0%
2023						
Gjinia	Burra			Gra		
	54.2%			45.8%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	43.1%		11.1%	40.3%	5.6%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	100.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	7.4%	55.4%	31.4%	5.8%	0.0%	0.0%

3.6. Ngjarjet kombëtare/Festivalet

Numri i vizitorëve dhe karakteristikat e tyre

Në vitin 2023, ngjarjet/festivalet kombëtare dominoheshin nga vizitorët lokal me 47,5 përqind, pasuar nga diaspora me 21,7 përqind, ndërkombëtarët me 11,8 dhe vizitorët e brendshëm vendorë me 19,00 përqind. Në vitin 2023, shumica e vizitorëve në ngjarje kombëtare/festivale ishin gjermanë (55,5 përqind), amerikanë (8,2 përqind), zviceranë (13,4 përqind) dhe shqiptarë (12,3 përqind). Për më shumë informacione, referojuni figurës 46.



Çmimet

Çmimi mesatar i biletës për një festival në vitin 2023 ishte mesatarisht 8.8 euro, krahasuar me 6.7 euro në vitin 2022. Kur u pyetën për shpenzimet mesatare të vizitorëve të huaj për një natë në vitin 2023, përfaqësuesit e ngjarjeve/festivaleve deklaruan se shpenzimet ishin 66.6 euro krahasuar me 45.3 euro në vitin 2022.

Punësimi

Në vitin 2023, shumica (69.1 përqind) e të punësuarve në ngjarje kombëtare dhe festivale ishin burra. Punëtorët me orar të pjesshëm përbënin 18.9 përqind nga numri i përgjithshëm i të punësuarve dhe punëtorët jo shqiptarë të Kosovës përbënin vetëm 5.2 përqind të tyre. Grupmoshat ndërmjet 15 deri në 34 vjeç përbënin 72.2 përqind të numrit të përgjithshëm të fuqisë punëtore. Për më shumë informacione dhe krahasime me vitet paraprake, ju lutemi referojuni tabelës 10.

Tabela 10: Demografia e punësimit (Ngjarjet /festivalet)						
2017						
Gjinia	Burra			Gra		
	70.6%			29.4%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)		Punë me orar të pjesshëm (gra)
	25.7%		44.9%	9.1%		20.3%
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	98.9%	0.5%	0.3%	0.1%	0.5%	0.1%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<

	18.5%	59.6%	20.3%	1.5%	0.2%	0.0%
2018						
Gjinia	Burra			Gra		
	70.9%			29.1%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	26.7%		44.2%	11.3%	17.8%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	96.1%	0.5%	0.9%	1.7%	0.8%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	35.9%	58.4%	5.6%	0.0%	0.0%	0.0%
2019						
Gjinia	Burra			Gra		
	68.4%			31.6%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	51.0%		17.5%	22.4%	9.2%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	98.7%	0.3%	0.3%	0.5%	0.2%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	31.2%	55.2%	10.2%	3.0%	0.4%	0.0%
2021						
Gjinia	Burra			Gra		
	74.6%			25.4%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	61.9%		12.7%	22.3%	3.1%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	97.4%	0.0%	0.7%	1.2%	0.7%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	30.8%	35.3%	20.3%	11.3%	2.1%	0.3%
2022						

Gjinia	Burra			Gra		
	67.4%			32.6%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	58.6%		8.8%	20.6%	12.0%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	92.6%	0.0%	1.3%	3.6%	2.5%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	22.1%	52.8%	18.3%	6.3%	0.5%	0.0%
2023						
Gjinia	Burra			Gra		
	69.1%			30.9%		
Punë me orar të plotë vs. punë me orar të pjesshëm	Punë me orar të plotë (burra)		Punë me orar të pjesshëm (burra)	Punë me orar të plotë (gra)	Punë me orar të pjesshëm (gra)	
	60.1%		8.9%	20.9%	10.0%	
Përkatësia etnike	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq	RAE	Boshnjakë	Të tjerë
	94.8%	0.0%	0.9%	2.7%	1.6%	0.0%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	32.6%	39.6%	19.1%	6.7%	2.0%	0.0%

4. Ndikimi ekonomik

Kjo pjesë shqyrton ndikimin ekonomik të akomodimeve, apartamenteve Airbnb dhe restoranteve në vitin 2023 si dhe krahason rezultatet e përgjithshme me vitet paraprake⁶. Në mënyrë të veçantë, vlerëson të ardhurat e përgjithshme të krijuara nga secili akter. Përveç kësaj, kjo pjesë gjithashtu paraqet numrin e përgjithshëm të punësuarve. Megjithatë, kjo qasje nuk mund të zgjerohej tek dy akterët e tjerë të zinxhirit të vlerës të ofertës së turizmit, për shkak të madhësisë së panjohur të popullacionit.

4.1. Akomodimet

Pika fillestare e kësaj analize ekonomike ishte numri i përgjithshëm i dhomave në dispozicion në vit. Ky numër është shumëzuar me normën mesatare të shfrytëzimit të banimit për të gjeneruar numrin total të dhomave të banuara në vit. Meqenëse ky raport është i fokusuar në turizëm, numri i dhomave të rezervuara nga banorët vendorë është zbritur. Çmimet mesatare të përshtatura duke marrë parasysh edhe dhomat superiore janë shumëzuar me numrin total të dhomave të banuara në vit (duke përjashtuar vizitorët vendorë) duke rezultuar në të ardhurat e vlerësuara të akomodimit nga mostra. Për ta bërë mostrën më përfaqësuese, është aplikuar faktori bruto. Të ardhurat e përgjithshme të sektorit në vitin 2023 arrijnë në 92.5 milion euro. Qasje e njëjtë është përdorur edhe për të llogaritur të ardhurat e apartamenteve Airbnb, që arrijnë në 22.7 milion euro, në vitin 2023. Për më shumë informata mbi hapat kryesorë të qasjes, shih tabelën 11 dhe 12.

⁶ Në rastin e akomodimeve me restorante, një pjesë e të ardhurave është alokuar për akomodime dhe pjesa tjetër për restorante. Ndarja është bërë në bazë të deklaratave të dhëna në anketë.

Tabela 11: Ndikimi ekonomik - akomodimet (duke përjashtuar apartamentet Airbnb)					
(a) Numri i dhomave në dispozicion – netëve në vit*					
Dhoma njëshe	Dhoma dyshe	Dhoma treshe	Dhoma katërshe	Vila	Të tjera
408,800	846,435	277,035	79,935	41,245	49,275
(b) Shkalla mesatare e banimit (%)					
57.20%					
(c) Numri i dhomave - netëve të banuara në vit (a*b)					
Dhoma njëshe	Dhoma dyshe	Dhoma treshe	Dhoma katërshe	Vila	Të tjera
233,834	484,161	158,464	45,723	23,592	28,185
(d) Proporcioni i dhomave - netëve të zëna nga vizitorët vendorë (%)					
19.00%					
(e) Numri i dhomave - netëve të zëna në vit, duke përjashtuar vizitorët vendorë (c-d)					
Dhoma njëshe	Dhoma dyshe	Dhoma treshe	Dhoma katërshe	Vila	Të tjera
189,405	392,170	128,356	37,035	19,110	22,830
(f) Mesatarja e çmimeve (€)**					
13,258,365	32,079,528	10,817,190	4,390,557	2,021,799	2,495,329
Dhoma njëshe	Dhoma dyshe	Dhoma treshe	Dhoma katërshe	Vila	Të tjera
70.0	81.8	84.3	118.6	105.8	109.3
(g) Të hyrat e vlerësuara të akomodimit nga mostra (€) Σ (e*f)					
65,062,768					
(h) Faktori Bruto/koefficienti					
1.423					
(i) Të hyrat e vlerësuara në sektorin e akomodimit (€) (g * h)					
92,584,318					
* Përjashtohen apartamentet Airbnb					
** E përshtatur duke marrë parasysh çmimet e dhomave superiore					

Tabela 12: Ndikimi ekonomik - apartamentet Airbnb					
(a) Numri i dhomave në dispozicion - netëve në vit *					
Dhoma njëshe	Dhoma dyshe	Dhoma treshe	Dhoma katërshe	Vila	Të tjera
7,665	16,060	1,825	1,095	7,665	-
(b) Shkalla mesatare e banimit (%)					
73.05%					
(c) Numri i dhomave – netëve të zënë në vit (a*b)					
Dhoma njëshe	Dhoma dyshe	Dhoma treshe	Dhoma katërshe	Vila	Të tjera
5,599	11,732	1,333	800	5,599	-
(d) Proporcioni i dhomave - netëve të zëna nga vizitorët vendorë (%)					
11.10%					
(e) Numri i dhomave - netëve të zëna në vit, duke përjashtuar vizitorët vendorë (c-d)					
Dhoma njëshe	Dhoma dyshe	Dhoma treshe	Dhoma katërshe	Vila	Të tjera
4,978	11,732	1,333	800	5,599	-
(f) Mesatarja e çmimeve (€)**					
174,221.7	457,541.4	78,656.6	49,593.6	307,960.5	-
Dhoma njëshe	Dhoma dyshe	Dhoma treshe	Dhoma katërshe	Vila	Të tjera
35	39	59	62	55	0
(g) Të hyrat e vlerësuara nga sektori i akomodimit nga mostra (€) $\Sigma (e*f)$					
1,067,974					
(h) Faktori Bruto/koeficienti					
21.3					
(i) Të hyrat e vlerësuara në sektorin e akomodimit (€) (g * h)					
22,747,842					

4.2. Restorantet

Ngjashëm me qasjen për akomodimet, numri i vizitave të klientëve në vitin 2023 është marrë si një shifër fillestare. Pas përjashtimit të vizitorëve vendorë, kjo shifër është shumëzuar me çmimin mesatar të ushqimit dhe pijeve për vizitë në njërin anë, dhe çmimin mesatar vetëm të pijeve në anën tjetër. Kjo ka prodhuar të ardhurat e parashikuara të gjeneruara nga restorantet e marrë si mostër. Pas aplikimit të faktorit bruto, janë gjeneruar të ardhurat e përgjithshme të vlerësuara nga restorantet për vitin 2023, me një vlerë prej 310.1 milion euro.

Tabela 13: Ndikimi ekonomik - restorantet	
(a) Numri i vizitave të klientëve në vit	
30,309,600	
(b) Proporcioni i klientëve vendorë (%)	
49.21%	
(c) Numri i vizitave të klientëve në vit, duke përfshirë vizitorët vendorë (a-b)	
15,394,246	
(d) Kontributi i ushqimit dhe pijeve në të hyrat e përgjithshme (%)	
Ushqimi dhe pijet	Vetëm pijet
60.4%	39.6%
(e) Mesatarja e çmimeve (€)	
Ushqimi dhe pijet	Vetëm pijet
12.4	4.6
(f) Të hyrat totale të vlerësuara nga mostra (€) (c*d*e)	
Ushqimi dhe pijet	Vetëm pijet
115,296,744	27,981,197
(g) Faktori Bruto/koefficienti	
2.1644	
(h) Të hyrat e vlerësuara në sektorin e restoranteve (€) $\Sigma(f*g)$	
310,110,775	

4.3. Të hyrat e përgjithshme të vlerësuara dhe punësimi

Përgjatë vitit 2023, të hyrat e përgjithshme të vlerësuara nga kategoria e akomodimeve, apartamenteve Airbnb dhe e restoranteve, ka shënuar rritje me rreth 27.04 përqind, krahasuar me vitin 2022. Rritja më e dukshme është vërejtur në të ardhurat e apartamenteve Airbnb. Për informata më të detajuara, shih tabelën 13.

Tabela 13: Të hyrat e vlerësuara (në €), 2017-2023				
Viti	Restorantet	Akomodimet	Apartamentet Airbnb	Total
v.2017	95,521,337	37,911,108	6,249,743	139,682,188
v.2018	140,712,183	42,384,201	7,460,332	190,556,716
v.2019	151,257,242	52,574,690	7,808,561	211,640,493
v.2020	101,450,527	20,870,416	2,309,075	124,630,018
v.2021	155,326,491	66,454,112	19,803,836	241,584,439
v.2022	225,697,849	85,424,400	23,769,438	334,891,687
v.2023	310,110,775	92,584,318	22,747,842	425,442,935




Tabela 13: Të hyrat e vlerësuara (në %), 2017-2023

Viti	Restorantet	Akomodimet	Apartamentet Airbnb	Total
v.2017	68.4%	27.1%	4.5%	100.0%
v.2018	73.8%	22.2%	3.9%	100.0%
v.2019	71.5%	24.8%	3.7%	100.0%
v.2020	81.4%	16.7%	1.9%	100.0%
v.2021	64.3%	27.5%	8.2%	100.0%
v.2022	67.4%	25.5%	7.1%	100.0%
v.2023	72.9%	21.8%	5.3%	100.0%